



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-7667/21
Kaçanik, 15.03.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III-të (Tretë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 15 Mars 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të 7 anëtarë: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës – Ylber Bajra dhe drejtori i DEFZH, Bahri Selimi, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë 7 anëtarë-të gjithë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e III-të (Tretë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 15 Mars, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Organogrami i Komunës së Kaçanikut; dhe
3. Propozim Vendim për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për Drejtor të Institucioneve Arsimore.

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, të pika e 2-të, Organogrami i Komunës është dashur të jetë me një shkresë përcjellëse, protokolluar dhe vulosur si material, Për mbledhje të Kuvendit të Komunës (KK) është mirë lënda të kompletohet. Ne e shqyrtojmë dhe diskutojmë. Ju njoftoj së kjo mbledhje e KPF dhe mbledhja e KK janë thirrur me urgjencë, për shkak të pikës 3 - me kërkesën e drejtorit të DAK, për shkak së e ka një konkurs të hapur, për të cilin konkurs vendimi për formim të komisioni duhet të merret në KK. Sidoqoftë, ne do të mundohemi që në fund të muajit mars apo në fillim të muajit prill, të mbajmë edhe ndonjë mbledhje tjetër, pasi ky vit është zgjedhor, në mënyrë që të përmbushim planin e mbledhjeve të KK dhe për mëditje të anëtarëve të KK, pasi që dy muajt e fundit të vitit nuk mund të mbajmë mbledhje, Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 3 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua pa vërejtje, me 1 Abstenim, Selim Reka, për shkak se i njëjti nuk ka qenë pjesë e procesit. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së II-të (Dytë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 23.02.2021 /Lënda: 01Nr. 60/03-5259/21.

2. Organogrami i Komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Unë e kam një pyetje; Në krahasim me organogramin e kaluar, sa është numri i punëtorëve, a do të thotë që ky organogram hynë në fuqi menjëherë dhe a votohet ky organogram ?

Kryesuesi i Kuvendit, Unë mendoj që organogrami paraqet organizimin e brendshëm të komunës, a votohet apo jo unë nuk e di. Meqë nuk kemi të bëjmë me drejtorin apo me ndarje të drejtorive, besoj se kalon sa për njoftim. Nënkryetari i Komunës-Ylber Bajra është prezentë në mbledhje për me na dhënë sqarime me të hollësishme.

Nënkryetari i Komunës-Ylber Bajra, Ky organogram është bërë në akordim me Statutin e komunës i cili është aprovuar në KK. Sigurisht se ka vende që duhet plotësuar, ndërkajq a plotësohen në këtë mandat apo në mandatin tjetër është problem me thënë, pasi që tani të gjitha konkurset së pari shpallen të brendshme, besoj se vendet plotësohen në mandatin tjetër kushdo që vjen. Organogrami nuk besoj që duhet votohet, për shkak se është një dokument në harmoni me statutin e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk besoj se duhet votohet organogrami i komunës, pasi që mund të bien në kundërshtim me statutin e komunës, kur dihet se me statut ka qenë marrëveshja që shtimi i dy drejtorive të bëhet në mandatin vijues të KK.

z. Zahir Doda-drejtor i DAK, Organogrami i komunës është kërkuar me u hartuar në pajtim me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës komunale. Nuk ka rritje të numrit të punëtorëve, unë flas për dy drejtoritë që dalin nga DAK, drejtorin e arsimit, dhe drejtorin e kulturës. meqë në vitin vijues do të formohet drejtorin e kulturës, nuk ka rritje të numrit të punëtorëve, eventualisht shtohet drejtorin i Drejtorisë së Kulturës. Në DAK janë 6 punëtorë ashtu edhe mbetën, ndërkajq dy punëtorë janë bartë, pasi që është palestra sportive, d.m.th. janë shtuar objektet kulturore dhe ka nevojë për mirëmbajtje dhe për udhëheqje, d.m.th. ka bartje të punëtorëve nga një sektor në sektorin tjetër e jo rritje të numrit të punëtorëve.

z. Ekrem Kyçyku, Të Auditimi i brendshëm shihet se është shtuar edhe një zyrtar,

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe 2 zyrtarë janë shtuar të auditimi i brendshëm. Ne e trajtojmë edhe këtë, edhe në KK, meqë ka ndryshime, ndoshta edhe duhet me votuar organogramin. Me një shkresë përcjellëse është dashur me na sqaruar se a votohet apo jo dhe për ndryshimet nëse ka të

numri i punëtorëve. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që ky organogram me këto plotësime t'i shkoj Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit. Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, u

Njoftua

Me Organogramin e Komunës së Kaçanikut, dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës, në procedurë për shqyrtim, me kërkesën që materiali të pajiset me sqarime shtesë nga DAP.

3. Propozim Vendim për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për Drejtor të Institucioneve Arsimore.

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, kjo është ajo pika për të cilën i ftuam mbledhjet e KPF dhe KK. Fillimisht i kam pasur do dilema, por të njëjtat më janë sqaruar nga drejtori. Sipas Udhëzimit administrativ, komisionin duhet të formoj KK. Drejtori i DAK është këtu prezentë nëse ka nevojë për sqarime. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Edhe unë kur e kam parë këtë Propozim Vendim që me u formuar një komision në KK pa pasur anëtarë të KK, nuk e kam pasur shumë të qartë. Sqarimi u dha nga kryesuesi së kjo është e përcaktuar me udhëzim administrativ, duhet me iu përmbajtur.

z. Ekrem Kyçyku, Diskutimi im ka të bëjë me tepër rreth anëtarëve të komisionit, të anëtari i dytë. E pash rastësisht në facebook së anëtari i dytë i propozuar është militant i PDK. Asnjë postim kjo drejtoreshë nuk e ka për arsim, por krejt për çështje politike. Kjo anëtare e komisionit dihet çfarë vendimesh mund të sjellë në përzgjedhje të drejtorëve të shkollave, nëse emërohet në këtë komision.

z. Zahir Doda, Udhëzimi administrativ i cili është aprovuar me 24 dhjetor 2020- për procedurat e zgjedhjeve të drejtorëve të shkollave, janë saktësuar saktë që DAK i propozon dy emra për anëtarë të komisionit. KK i miraton dy emrat e propozuar nga DAK. KK nuk e formon komisionin, por i miraton dy emrat që do të jenë në komisionin të cilin e formon kryetari i komunës me 2 anëtarët që i voton KK dhe 1 anëtar të cilin e emëron ministria dhe 2 vëzhgues të cilët janë pjesë përbërëse e komisionit, por që të njëjtit nuk kanë të drejtë të vlerësimit. Njëri duhet të jenë nga këshilli i prindërve dhe tjetri nga këshilli drejtues i shkollës. Tani një anëtarë duhet të jetë nga DAK që do të jetë kryetar i komisionit. Unë nuk kam tjetër të nivelit të kërkuar përpos Hajrush Dullovi edhe Gafurr Guri, por Gafurri merret me shkollat e mesme të ulëta, dhe me është dukur me e arsyeshme me caktuar Hajrush Dullovi në këtë komision. Anëtari tjetër duhet të jetë drejtor i institucionit, në nivel të barabartë me drejtorin, kjo shkruan edhe në UA. Mirëpo MASH na sugjeron që njëri anëtarë i propozuar nga DAK të jetë femër. Femra tjera -drejtore shkollave nuk ka të punësuar, pos Florije Zeneli, kështu që ky emër me është imponuar në njëfarë forme. KK i duhen dy emra të propozuar nga DAK me i miratuar. E kam pyetur komunën e Hanit Elezit, ata i kanë aprovuar dy emra. E kam pyetur komunën e Ferizajt, ata janë në procedurë të emërimit të komisionit. Komuna e Drenasit i kishin miratuar dy emra në KK të propozuar nga drejtoria e Arsimit. E kam pyetur edhe komunën e Lipjanit edhe Lipjani ka caktuar dy emra nga drejtoria e Arsimit. Nga 5 komuna që i kam pyetur, të gjithë iu kanë përgjigjur njësoj. Ky vendim nuk shkon në MPL dhe mbetet me vazhduar me procedurën e më tutjeshme.

z. Ekrem Kyçyku, Vërejtjet e mia janë të kandidati i dytë, sepse ajo drejtore e shkollës asnjë fjalë për arsim nuk ka në llogarinë e saj, përpos për politikë. Unë nuk e di si i mundemi ne të kemi besim në anëtarin e dytë.

z. Nexhat Loku, A parashihet ndonjë afat i caktuar për formimin e komisionit?

z. Zahir Doda, Kuvendi i Komunës ka të drejtë që komisionit me i dhënë mandat deri në një vit shkollor.

znj. Hafize Sallahi, A ka tani konkurs të hapur për ndonjë drejtor shkolle ?

z. Zahir Doda, Konkurs të hapur ka për drejtor të shkolle për ; Gllloboqicë dhe për Doganaj. Sipas të gjitha gjasave do të ketë edhe konkurse tjera, pasi 2 drejtorëve të shkollave të mesme iu kalon mandati sivjet. Tani e kemi edhe drejtorin SHF " Emin Duraku" i cili ka ofruar dorëheqje për shkaqe shëndetësore, nuk e kemi shqyrtuar ende dorëheqjen, por sipas të gjitha gjasave ka arsytet e veta drejtori që ka ofruar dorëheqje.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Për ishin të gjithë, kështu që konstatohet së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për Drejtor të Institucioneve Arsimore dhe i njëjti i ,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Për fund drejtori i DAK, z. Zahir Doda bëri thirrje që mos me bllokuar si proces çështja e formimit të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, përndryshe nëse ka ndonjë zgjidhje tjetër, nuk e di sa ka të drejtë KK me ndryshuar anëtarin e dytë, por mua nuk me pengon asgjë me u ndryshuar emri i kandidatit të dytë.

z. Ekrem Kyçyku, Anëtar i dytë i komisionit me qenë person apolitik, do të ishte shumë më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:28. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin në mbledhje.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 18 mars 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Kemal Mërseli